

PULSAR



PERSPEKTIVA PËR
TË ARDHMEN



PROGRAMI PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN NË SEKTORIN PUBLIK

PËRSE KA RËNDËSI KONTABILITETI I SEKTORIT PUBLIK (KSP) DHE RAPORTIMI FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK?

Qeverive u besohet administrimi i burimeve publike dhe realizimi i një game të gjerë shërbimesh publike në mënyrë të shëndoshë dhe të qëndrueshme dhe me efektivitet të kostos. Vendet përballen me mangësi të ndjeshme në raportimin financiar, të cilat cenojnë qëndrueshmërinë, ku përfshihet edhe raportimi jo transparent i deficiteve fiskale dhe i borxhit shtetëror.

Informacioni cilësor financiar i dalë nga një paketë solide standardesh ndërkombëtare çon në një vendimarrje më të mirë në mbështetje të krijimit dhe shpërndarjes së burimeve. Ai mbështetet llogaridhënien, rrit transparencën fiskale, nxit njëtrajtshmërinë dhe mundëson krahasueshmërinë me homologë të tjerë brenda rajonit dhe në mbarë botën.

CILI ËSHTË OBJEKTIVI I PROGRAMIT PULSAR?

Objektivi i këtij programi është dhënia e mbështetjes për përmirësimin e kuadrit të KSP-së dhe raportimit të financiar të vendeve pjesëmarrëse në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën e mira, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, transparenca dhe ecuria e qeverive.

CILA ËSHTË FUSHA E VEPRIMIT E PROGRAMIT PULSAR?

PULSAR është një program në nivel rajoni dhe vendi për të mbështetur zhvillimin e kuadrit të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në vendet përfituese. Në nivel rajonal, programi PULSAR punon në tri fusha të gjera të cilat përforcojnë njëra-tjetrën, duke siguruar një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe duke kontribuar në rritjen e llogaridhënies, transparencës dhe ecurisë së qeverive.

CILAT JANË VENDET E TANISHME PËRFITUESE TË PROGRAMIT PULSAR?

	Shqipëria		Gjeorgjia
	Armenia		Kosova
	Azerbajxhani		IRJ e Maqedonisë
	Bjellorusia		Moldavia
	Bosnja dhe Hercegovina		Mali i Zi
	Kroacia		Serbia
			Ukraina



ÇFARË AKTIVITETESH KONKRETE PARASHIKOHEN NË KUADËR TË PROGRAMIT RAJONAL DHE PROGRAMEVE NË NIVEL VENDI?

ÇFARË?

SI?

NË NIVEL RAJONAL

NË NIVEL VENDI

1: Rritja e ndërgjegjësimit për arsyet e reformës

OBJEKTIVI  Ndërgjegjësimi & arritja e konsensusit të palëve të interesit për programin e reformës	Analizë e mjedisit të tanishëm të kontabilitetit & raportimit financiar të sektorit publik	Konferenca, seminare pune & udhëzues	Seminare pune me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit
	Përshkrim i përfitimeve, qasjeve, risqeve & kostove të reformës	----- Blog për KSP-në	----- Analizë e lidhjeve me fushat e tjera të MFP-së
	Evidentimi i marrëdhënies me reformat e tjera të menaxhimit të financave publike (MFP)	----- Arkiv online	----- Qasje tërësore ndaj reformave të KSP-së

2: Mbështetja për hartimin & vënien në zbatim të kuadrit të raportimit financiar

OBJEKTIVI  Analizë e boshllëqeve, përgatitje e udhërrëfyesit të reformës & fuqizimi i kuadrit legjislativ, vendosjes së standardeve & kontrollit të zbatimit të tyre	Mbështetja për zyrtarët shtetërore në hartimin e strategjive & dokumenteve udhërrëfyese për reformën	Komunitetet e Praktikës (lidhje me PEMPAL) ----- Lidhjet midis raportimit financiar, të drejtimit, statistikor, të ecurisë dhe të buxhetit	Analiza e boshllëqeve: kuadri, praktikat, kontrolli i zbatimit ----- Përgatitja e kuadrit, dokumenteve udhërrëfyese, standardeve, politikave & planit kontabël
	Dhënia e ndihmës qeverive në hartimin & zbatimin e legjislacionit/standardeve/sistemit informatik/instrumenteve	----- Analizë e situatës së reformave & praktikës në rajon & krahasim me rajonet e tjera ----- Përmirësim i Instrumentit Diagnostikues të BB-së për SNKSP-të	----- Vënia graduale në zbatim e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) ----- Lidhja me reformat e tjera të MFP-së

3: Mbështetja për zhvillimin e kontabilistëve & profesionistëve financiarë

OBJEKTIVI  Nxitja e zhvillimit të formimit, edukimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të sektorit publik në harmonizim me standardet & praktikën e mirë ndërkombëtare	Formimi, edukimi, certifikimi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP) për personelin financiar & kontabël	Komuniteti i Praktikës për Edukimin ----- Qasjet, programet mësimore dhe mjetet dhe burimet e tjera të formimit	Mbështetje e përshtatur për përmbushjen e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në bazë të analizës & profilit të universitetit dhe organeve profesionale të realizuar në kuadër të programeve EU-REPARIS dhe STAREP
	Nxitja e profesionalizmit të funksionit të financave në sektorin publik	----- Kuadri i elementeve minimale të aftësisë për profesionistët financiarë të sektorit publik ----- Trajnim i trajnuesve për SNKSP-të	----- Realizimi i nismave mësimore ----- Zhvillimi i një mekanizmi të qëndrueshëm për formimin profesional

CILI DO TË JETË NDIKIMI I PROGRAMIT PULSAR?

- Rritje e ndërgjegjësimit dhe shkëmbimit të njohurive përmes shkëmbimit mes kolegëve, transferimit të njohurive dhe bashkëpunimit rajonal.
- Përmirësim i akteve ligjore/nënligjore të vendeve të ndryshme përmes asistencës teknike dhe mbështetjes për zbatimin.
- Përmirësim i organizimit institucional përkatës për raportimin financiar të sektorit publik dhe zhvillim i kapaciteteve institucionale për vendosjen e standardeve, kontrollit të cilësisë dhe për vënien në zbatim.
- Përmirësim i proceseve kombëtare për hartimin, miratimin, përkthimin dhe shpërndarjen e standardeve dhe instrumenteve, si edhe të materialeve edukative përkatëse.
- Ngritja e programeve të formimit, edukimit, certifikimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional në përputhje me praktikën e reja më të mira.

CILËT JANË PARTNERËT E PROGRAMIT PULSAR?

Partnerët e programit PULSAR - Austria, Zvicra dhe Banka Botërore - kanë vendosur bashkërisht objektivat dhe fushën e veprimit të programit PULSAR. Ata japin mbështetje institucionale për zbatimin e tij dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për aktivitetet e tij.

Edhe vendeve përfituese u jepet mundësia t'i japin trajtë këtij programi përmes platformave të bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve në komunitetet e praktikës.

PULSAR

Programi PULSAR

menaxhohet nga:



WORLD BANK GROUP

CFRR 
**Centre for Financial
Reporting Reform**



WORLD BANK GROUP
Governance

bashkëfinancohet nga:



BMF

**AUSTRIAN FEDERAL
MINISTRY OF FINANCE**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO